

VENDIM
Nr. 953, datë 29.12.2014

**PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN
E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligj”, ligji nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
2. “TVSH/tatimi”, tatimi mbi vlerën e shtuar në kuptim të ligjit.
3. “Përfjashtim”, përfjashtimi nga TVSH-ja sipas kuptimit të ligjit;
4. “OJF”, organizatë jofitimprurëse sipas kuptimit të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”.
5. “Zbritja e TVSH-së”, e drejta për të zbritur TVSH-në për furnizimet e marra sipas kuptimit të ligjit.

Neni 2
Kriteret për zbatimin e përfjashtimit për organizatat jofitimprurëse

Në zbatim të nenit 51, shkronjat “ë”, “f”, “i”, “j”, “k”, përfjashtohen nga TVSH-ja nëse plotësojnë kriteret dhe procedurën sipas këtij vendimi furnizimet e mëposhtme të kryera nga organizatat jofitimprurëse:

1. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me ndihmën dhe asistencën sociale, përfshirë veprimet që kryejnë shtëpitë e kujdesit për të moshuarit;
2. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve;
3. Furnizimi i shërbimeve të caktuara, të lidhura ngushtë me ushtrimin e sportit ose të edukimit fizik, që u ofrohen personave që marrin pjesë në ushtrimin e sportit apo të edukimit fizik;
4. Furnizimi i shërbimeve të caktuara kulturore dhe edukative, si dhe mallrave që lidhen ngushtësisht me to.

II. Kriteret për vlerësimin e qëllimit jofitimprurës të organizatës

Këto furnizime me karakter shoqëror, edukativ, kulturor, sportiv përfjashtohen nga TVSH-ja kur kryhen nga organizma publikë apo nga organizata pa qëllim fitimi me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përfjashtim

nga TVSH-ja, me kusht që çmimet e furnizimeve që ofron organizata jofitimprurëse të jenë më të ulëta se ato që ofrohen për furnizime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së, me qëllim që të mos sjellë shtrembërim të konkurrencës.

Zbatimi i përjashtimit nga TVSH-ja kërkon të plotësohen tri kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Organet drejtuese të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës.

2. Veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë, duke marrë në konsideratë të ardhurat përkatëse, duhet të kenë epërsi të ardhurat nga veprimtaria joekonomike e organizatës.

3. Furnizimet që kryhen nga organizatat jofitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë sektorin tregtar fitimprurës. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, e kryer prej këtyre organizatave për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse, për të cilën janë krijuar, të arkëtuara gjatë vitit kalendarik, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës.

Nocioni i “të ardhurave të përgjithshme” përmbledh të gjitha burimet financiare të organizatës, përfshirë të ardhurat nga furnizimet dhe subvencionet e shfrytëzimit.

III. Organizmat që përfshihen sipas formës së organizimit të tyre

Organizmat që përfitojnë nga ky përjashtim kur plotësojnë kriteret e sipërpërmendura për veprimtarinë ekonomike që ato kryejnë janë:

-shoqatat me interes të përgjithshëm të organizuara në një formë, të tillë si organizatat politike, sindikaliste, profesionale, filozofike ose fetare, shoqatat kulturore, social-kulturore ose sportive, shoqatat folklorike etj;

-organizatat e krijuara sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, të cilat veprojnë pa qëllime fitimi, të tilla si fondacione, grupime të ndërvarura, komitete të ndryshme.

Këto organizata jofitimprurëse, që veprojnë në këtë mënyrë, përjashtohen për shërbimet me karakter social, edukativ, kulturor apo sportiv, si dhe për furnizimet e mallrave që u ofrojnë me çmime të reduktuara kryesisht anëtarëve të tyre por edhe të tjerëve, si pjesë e aktivitetit dytësor të tyre të kryer në funksion të qëllimit të tyre jofitimprurës. Organizatat pa qëllim fitimi nuk duhet të përdorin reklamat, të njohura si praktika të përdorura për arsye tregtare, të cilat u drejtohen personave joanëtarë për të reklamuar ose për të bërë të njohur veprimtarinë e organizatës. Nëse ato reklamojnë veprimtarinë e tyre, atëherë furnizimet e tyre nuk përfitojnë nga ky përjashtim.

Në kuadër të furnizimit të shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, cildo qoftë personi juridik, ent publik, shoqatë, ndërmarrje, përjashtohen furnizimet e kryera nga institucionet që kujdesen për fëmijët e moshës deri në tre vjeç të cilat që në gjuhën e përditshme njihen “çerdhe”.

IV. Për zbritshmërinë e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse që përfitojnë nga përjashtimi prej TVSH-së për furnizimet që ofrojnë në kuadër të veprimtarisë së tyre ekonomike, nuk kanë të drejtë të zbresin TVSH-në për mallrat dhe shërbimet e blera për qëllime të furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja

V. Detyrimi për deklaratën e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike, si veprimtari dytësore të tyre, edhe kur përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së sipas këtij vendimi detyrohen të bëjnë deklaratimet për TVSH-në në afatet dhe formën që përcaktohet në ligj. Në deklaratën e TVSH-së do të deklarohen vetëm furnizimet e kryera në kuadër të veprimtarisë ekonomike si shitje dhe blerje të përjashtuara nga TVSH-ja.

VI. Nëse ndonjëri nga tri kriteret e përmendura në pikën II nuk plotësohet, atëherë furnizimet që kryen organizata nuk përfitojnë nga përjashtimi.

VII. Përfitojnë nga përjashtimi organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, duke plotësuar të njëjtat kushte dhe kriteret si personat fizikë dhe juridikë që kanë qëllime fitimi.

VIII. Organizatat, që përfitojnë nga përjashtimi për të paguar TVSH sipas këtij vendimi, përfitojnë gjithashtu nga përjashtimi i TVSH-së në import për mallrat në funksion të veprimtarisë së tyre jofitimprurëse.

Neni 3

Procedura për aplikimin e përjashtimit nga organizatat jofitimprurëse

1. Organizata jofitimprurëse, e cila kryen veprimtari ekonomike si veprimtari dytësore të saj dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 1, të këtij vendimi, që të aplikojë përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që kryen, detyrohet të kryejë procedurat e mëposhtme:

Paraqet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar dokumentet e mëposhtme:

- a) Vendimin e gjykatës (fotokopje e noterizuar);
- b) Statutin e organizatës jofitimprurëse dhe kontratën e themelimit;
- c) Një deklaratë në të cilën deklaron të listuara të gjitha shërbimet dhe mallrat që furnizon për anëtarët e saj ose për persona të tretë së bashku me çmimet që organizata aplikon për secilin furnizim;
- ç) Një deklaratë ku shpreh misionin dhe qëllimin e OJF-së, si dhe identifikon programet kryesore të veprimtarisë;
- d) Një deklaratë ku të deklarohet dhe të identifikohet kategoria e personave, grupeve në nevojë, të cilëve u shërben;
- dh) Një deklaratë ku të specifikojë burimet e financimit të organizatës sipas zërave, përfshirë edhe të ardhurat e realizuara ose të pritshme nga veprimtaria ekonomike.

Në këtë deklaratë, organizata duhet të deklarojë në përqindje të përafërt të pjesës që zë ose pritet të zërë veprimtaria ekonomike e organizatës në raport me atë joekonomike. Kjo deklaratë kërkohet si në rastin kur organizata është regjistruar rishtas dhe nuk ka kryer më parë veprimtari ekonomike edhe në rastin kur ka kryer veprimtari bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara në organin tatimor.

2. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar organizata ngre një grup pune (me 2 deri 3 punonjës), i cili shqyrton rastin bazuar në dokumentacionin e paraqitur, situatën që paraqet organizata, historikun e saj (nëse ka) si dhe çdo të dhënë tjetër që disponon.

3. Bazuar në rezultatet e verifikimit, kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 2, të këtij vendimi, brenda 25 ditëve pune, grupi i punës i paraqet një raport drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i propozuar miratimin e përjashtimit nga TVSH-ja për furnizimet që kryen organizata.

4. Nëse gjykohet e nevojshme mund të kryhet edhe verifikim në vend i veprimtarisë së organizatës për llojet e furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve të kryera dhe çmimet që aplikon për secilin furnizim. Edhe nëse verifikimi nuk kryhet paraprakisht ai mund të kryhet në çdo kohë prej autoritetit tatimor.

5. Në përfundim të procedurës, jo më vonë se 5 ditë pune, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lëshon autoizimin për përjashtimin nga TVSH-ja. Nëse autorizimi refuzohet, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve jep arsyet, për të cilat përjashtimi nga TVSH-ja nuk mund të aplikohet prej organizatës.

6. Lëshimi i autorizimit për përjashtim nga TVSH-ja është i vlefshëm për 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kriteret si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

Për organizatat jofitimprurëse që regjistrohen për herë të parë, autorizimi i përjashtimit nga TVSH-ja është i vlefshëm për 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kriteret si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

7. Në rast se konstatohet se kushtet kanë ndryshuar më parë se afati i përcaktuar në pikën 6, të këtij neni, atëherë Drejtoria Rajonale Tatimore në çdo kohë ka të drejtë të rishqyrtojë përjashtimin nga TVSH-ja.

8. Nuk i nënshtrohen procedurës sipas këtij neni organizatat jofitimprurëse të cilat nuk kryejnë veprimtari ekonomike në kuadër të veprimtarisë jofitimprurëse dhe në përputhje me nenin 3, të ligjit, konsiderohen persona të patatueshëm për TVSH-në. Këta persona nuk regjistrohen për TVSH-në.

Gjithashtu, nuk i nënshtrohen kësaj procedure organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë veprimtari ekonomike të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit, si p.sh. shërbime shëndetësore, arsimore etj, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore.

Neni 4

Manifestimet e kryera nga organizatat jofitimprurëse për qëllime bamirësie ose mbështetje të shtresave në nevojë

1. Në zbatim në shkronjës “I”, të nenit 51, të ligjit, furnizimi i shërbimeve dhe mallrave të kryera nga organizatat jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave përjashtohet nga TVSH-ja, në raste të manifestimeve ose organizimeve për mbledhje fondesh ekskluzivisht për qëllime bamirësie ose në funksion të përmbushjes së qëllimit të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, përjashtohen nga TVSH-ja nëse numri i këtyre manifestimeve ose organizmave nuk kalon 5 (pesë) të tilla në vit. Nëse organizohen më shumë manifestime të tilla, përjashtimi nga TVSH-ja aplikohet për të ardhurat e mbledhura vetëm për pesë manifestime.

Megjithatë pavarësisht nga numri, përjashtimi nuk aplikohet nëse organizimi i këtyre manifestimeve me pagesë dhe të hapura për publikun ka karakter të shpeshtë.

2. Përjashtimi nuk aplikohet për furnizimet e kryera nga personat fizikë ose juridikë tregtarë edhe nëse janë të autorizuar nga organizatorët e manifestimit, që të ushtrojnë për llogarinë e tyre disa veprimtari gjatë zhvillimit të manifestimit, të tilla si shitje produktesh të ndryshme, shfrytëzimi i stendave, bareve etj.

Neni 5

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Në zbatim të pikës 2 të nenit 55 të ligjit, personat e tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën të zgjedhin të aplikojnë dhe paguajnë TVSH për furnizimin e qiradhënies së ndërtesës duke e trajtuar atë jo si furnizim të përjashtuar, por si furnizim të tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së 20%.

2. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që japin me qira ndërtesa (ambiente) për banim.

3. E drejta e zgjedhjes zbatohet për ndërtesa që qiramarrësit i përdorin për nevojat e veprimtarive të tyre të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të TVSH-së, si veprimtari të tatueshme, ose të përjashtuara nga TVSH-ja, si dhe për veprimtaritë që ndodhen jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

4. Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1, të këtij neni, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përveç nëse qiramarrësi është një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e qirasë të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga qiradhënësi dhe pranimi i saj nga qiramarrësi.

5. Në rastin kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron qiradhënësin e ardhshëm që në deklaratën për zgjedhjen të përcaktojë, të identifikojë qartë ndërtesën (ambientet) /ndërtesat për t'u përdorur për veprimtari qiradhënieje të tatueshme.

6. Ndryshimi i qiramarrësit ose veprimtarisë së tij nuk cenon vlefshmërinë e zgjedhjes, me kusht që kontrata e re e qiradhënies, nëse kërkohet një e tille, e lidhur me një qiramarrës tjetër të përmbajë klauzolën që tregon se zgjedhja e aplikimit të TVSH-së është ushtruar nga qiradhënësi. Në rastin kur qiramarrësi i ri, një person i patatueshëm ose i përjashtuar nuk e pranon zgjedhjen, atëherë e drejta e zgjedhjes për të aplikuar TVSH-në e humb fuqinë e saj dhe nuk mund të ushtrohet për ambientet përkatëse.

7. Në rastin kur autoriteti tatimor konstaton një situatë abuzimi ose mashtrimi, atëherë kjo përbën një arsye të forte për të rrëzuar zgjedhjen e aplikuar prej qiradhënësit.

8. Personat e tatueshëm që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes duhet ta ushtrojnë atë në përputhje me këto kritere, si dhe modalitetet dhe rregullat e përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të këtij vendimi.

Neni 5/1

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës ose i pjesëve të një ndërtese

1. Në zbatim të pikës 2, të nenit 55, të ligjit, personat e tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën të zgjedhin të aplikojnë dhe të paguajnë TVSH-në për furnizimin e ndërtesës ose pjesëve të një ndërtese, duke e trajtuar furnizimin jo si të përjashtuar, por si furnizim të tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së prej 20%.

2. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që furnizojnë apartamente, ndërtesa apo ambiente për banim ose kur blerësi është një individ. Për qëllime të zbatimit të kësaj dispozite, me “apartamente, ndërtesa ose pjesë të saj apo ambiente për banim” kuptohen ato objekte të cilat furnizohen për qëllime banimi dhe blerësi është një person i tatueshëm, individ. E drejta e zgjedhjes ushtrohet për ndërtesat ose pjesë të ndërtesës, të cilat furnizohen (shiten) për qëllim përdorimi për veprimtarinë ekonomike të blerësit, subjekt i regjistruar, ose për qëllime rishitjeje prej tij, por jo për banim.

3. Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1, të këtij neni, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përveç nëse blerësi është një person juridik i patatueshëm ose një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e furnizimit të ndërtesës të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga furnizuesi dhe pranimi i saj nga blerësi.

4. Në rastin kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron furnizuesin e ndërtesës që në deklaratën për zgjedhjen të përcaktojë, të identifikojë qartë ndërtesën (ambientet) /ndërtesat me destinacion përdorimi ose shitjeje për qëllime biznesi dhe ndërtesat për t’u përdorur për qëllime banimi.

5. Në rastin kur blerësi, një person juridik i patatueshëm ose i përjashtuar nuk e pranon zgjedhjen, atëherë e drejta e zgjedhjes për të aplikuar TVSH-në e humb fuqinë e saj dhe nuk mund të ushtrohet për ambientet përkatëse.

6. Në rastin kur autoriteti tatimor konstaton një situatë abuzimi ose mashtrimi, atëherë kjo përbën arsye për të rrëzuar zgjedhjen e aplikuar prej furnizuesit të ndërtesës.

7. Personat e tatueshëm, që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes për furnizimin e ndërtesës sipas këtij neni, duhet ta ushtrojnë atë në përputhje me këto kriteret, si dhe modalitetet e rregullat e përcaktuara në nenet 6/1 dhe 7/1, të këtij vendimi.

8. Për qëllime të zbatimit të së drejtës së zgjedhjes sipas neneve 5/1, 6/1 e 7/1, kjo e drejtë ushtrohet për furnizimin e ndërtesës ose pjesë të ndërtesës, momenti i furnizimit të së cilës është pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

(Ndryshuar me VKM nr. 8, dt. 11.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 16 janar 2017).

Neni 6

Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur më parë një deklaratë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku deklarohet se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm. Kjo deklaratë e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për të futur në regjimin normal të TVSH-së, veprimtarinë e tij të dhënies me qira të ndërtesës, përmban të dhënat identifikuese për çdo ndërtesë të dhënë me qira, si dhe të dhënat e personit qiramarrës (emri, NIPT-i, adresa etj).

2. Për aplikimin e së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Personi i tatueshëm qiradhënës duhet të depozitojë, përveç deklaratës edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës së qirasë nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm.

3. Në rast se qiradhënësi kryen furnizim qiradhënieje për subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, qiradhënia trajtohet si furnizim i tatueshëm, vetëm në rast se në kontratën e qiradhënies, qiramarrësi është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH për qiranë. Në këtë rast, qiradhënësi duhet t'i bashkëlidhë deklaratën me shkrim edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm. Në këtë rast, qiramarrësi nuk mund të heqë dorë nga fakti që të paguajë TVSH për qiranë të paktën deri në përfundim të afatit të kontratës së qirasë.

Shembuj të qiradhënies për veprimtari të përjashtuar ose jashtë fushës së TVSH-së, ku qiradhënësi pavarësisht nga dëshira e shfaqur për të zbatuar zgjedhjen e TVSH-së, e ushtron të drejtën pasi ka rënë dakord me qiramarrësin:

Palët bien dakord paraprakisht për zbatimin e TVSH-së ose jo:

- të qiradhënies së një ndërtese për t'u përdorur si zyrë ku qiramarrës është një bashki që e përdor për pritjen e komunitetit të zonës, pra për një veprimtari të patatueshme me TVSH;
- të qiradhënies së një ndërtese (ambienti) për t'u përdorur si zyrë e dhënë me qira një zyre përfaqësimi, për nevojën e veprimtarisë së saj.

4. Në ndërtesat ose grupet e ndërtesave, ku përfshihen ndërtesa (ambiente) për të cilat qiradhënësi zgjedh të trajtojë qiradhënien e tyre si të tatueshme, por edhe ndërtesa (ambiente) të tjera për banim, e drejta e zgjedhjes nuk shtrihet te ndërtesat për banim, por zbatohet për të gjitha ndërtesat e tjera sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Me grup ndërtesash kuptohet jo vetëm një grup ndërtesash që kanë qenë objekt i të njëjtit studim të terrenit, leje ndërtimi ose programi ndërtimi, të realizuar në një terren që i përket të njëjtit person, por edhe dy apo më shumë ndërtesave të ndërtuara në të njëjtin terren.

5. Zgjedhja nis ditën e parë të muajit në të cilin ajo formulohet. Pas fillimit të ushtrimit, zgjedhja zbatohet për aq kohë sa nuk ka qenë objekt ndërprerjeje.

Neni 6/1

Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për furnizimin e ndërtesës

1. Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore një deklaratë me shkrim, ku deklarohet se furnizimi i ndërtesës do të trajtohet si furnizim i tatueshëm me TVSH 20%. Kjo deklaratë, e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për

të aplikuar regjimin normal të TVSH-së për furnizimin e ndërtesës, përmban të dhënat për çdo ndërtesë/ambient, të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm blerës (emri, NIPT-i adresa etj.) si dhe të dhënat mbi lejen e ndërtimit dhe qëllimin e përdorimit të ndërtesës.

2. Për qëllime të së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis furnizuesit dhe blerësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se furnizimin e ndërtesës do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Furnizuesi duhet të disponojë në çdo rast kontratën përkatëse të furnizimit, të cilën e vë në dispozicion të autoriteteve tatimore, kur i kërkohet. Mungesa e kontratës së furnizimit nuk i jep të drejtën e trajtimit të shitjes së ndërtesës si furnizim i tatueshëm. Gjithashtu, në këtë kontratë midis palëve duhet të jenë shprehur qartë lloji, natyra, qëllimi i përdorimit si dhe të dhënat identifikuese të blerësit (emri, NIPT-i, adresa etj.). Në rastin kur ndërtesa përdoret për qëllime të veprimtarisë ekonomike nga vetë personi i tatueshëm ndërtues ose nga investitori, në mungesë të kontratës së furnizimit, përveç kontratës së ndërtimit midis ndërtuesit dhe investitorit dhe lejes përkatëse të ndërtimit, personi i tatueshëm që aplikon të drejtën e zgjedhjes, paraqet një deklaratë noteriale për qëllimin e përdorimit të ndërtesës.

3. Në rast se personi i tatueshëm ia furnizon (shet) ndërtesën personave të tatueshëm, të cilët ushtrojnë veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja, furnizimi i ndërtesës trajtohet me TVSH, vetëm në rast se në kontratën e furnizimit, personi i tatueshëm blerës është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH-në. Në këtë rast, furnizuesi disponon dhe paraqet edhe kontratën përkatëse. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të furnizimit si të tatueshëm.

4. Në ndërtesat ose grupet e ndërtesave, ku përfshihen ndërtesa (ambiente) për të cilat furnizuesi zgjedh opsionin për t'i trajtuar si të tatueshme, por edhe ndërtesa (ambiente) të tjera për banim, e drejta e zgjedhjes nuk shtrihet te ndërtesat për banim, por zbatohet për të gjitha ndërtesat e tjera sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen. Lloji i ndërtesës, natyra e saj dhe qëllimi i përdorimit përcaktohen gjithashtu në lejen e ndërtimit apo miratimet e mëvonshme të marra për zbatimin e lejes. Në rastet kur nuk është e mundur të identifikohet nëse ndërtesa është shitur për qëllime banimi ose jo, atëherë leja e ndërtimit shërben si dokument justifikues dhe vërtetues për të gjykuar mbi aplikimin e opsionit.

5. Zgjedhja nis ditën e parë të muajit në të cilin ajo formalizohet. Pas fillimit të ushtrimit, zgjedhja zbatohet për atë kohë sa nuk ka qenë objekt ndërprerjeje.

(Ndryshuar me VKM nr. 8, dt. 11.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 16 janar 2017).

Neni 7

E drejta e zbritjes kur ushtrohet zgjedhja

1. Në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për çdo ndërtesë ose grup ndërtesash që janë përfshirë për t'u trajtuar si të tatueshme ose për çdo ndërtesë ose grup - ndërtesash të cilat i jep me qira si të përjashtuara nga TVSH-ja, qiradhënësit duhet të evidentojnë veçmas zbritjet e TVSH-së për secilën nga ndërtesat ose grup - ndërtesat.

2. Gjithashtu, qiradhënësit që përveç veprimtarisë së qiradhënies ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet t'i evidentojnë veçmas shpenzimet për secilën kategori të veprimtarisë.

3. Në rastin kur ndërtesa ose grupi i ndërtesave, për të cilin është kërkuar zgjedhja, përfshin ndërtesa (ambiente) për të cilat është ushtruar e drejta e zgjedhjes për t'i trajtuar të tatueshme me TVSH, në përputhje me dispozitat e ligjit, si dhe ndërtesa (ambiente) për të cilat nuk ushtrohet ose nuk është e lejuar të ushtrohet e drejta e zgjedhjes si ambiente për banim ose ambiente të dhëna me qira për nevojat e veprimtarisë së marrësve të patatueshëm ose të përjashtuar nga TVSH-ja të cilët në kontratën e qirasë nuk kanë formuluar shprehimisht të drejtën e zgjedhjes ose ambientet për përdorim profesional të cilat ende nuk janë dhënë realisht me qira (për to e drejta e zgjedhjes nuk mund të prezumohet për sa kohë që, sipas ligjit, qiradhënia mbi 2 muaj është furnizim i përjashtuar), TVSH-ja zbritet vetëm për tërësinë e ambienteve të përfshira realisht nga e drejta e zgjedhjes së TVSH-së.

4. Në lidhje me ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së, kjo zbritje lejohet për ndërtesën/at, të cilat edhe nëse nuk janë dhënë efektivisht me qira, por qiradhënësi, i cili i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe nëpërmjet elementeve objektive, vërteton se ai e jep me qira ambientin. Për këtë qëllim, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Kontrata të lidhura nga qiradhënësi apo çdo qasje tjetër ligjore të ndërmarrë prej tij dhe që vërteton përpjekjet e tij për të kërkuar qiramarrës për ndërtesat, ambientet për përdorim profesional të cilat kanë mbetur të lira (vakante);

- Ndërtesat, të cilat nuk janë ende objekt i një kontrate qiraje ose të një premtimi për qiradhënie në momentin e formulimit të zgjedhjes, duhet të përbëjnë një pjesë të vogël të tërësisë së ndërtesës ose ambienteve për përdorim profesional të ndërtesës në fjalë. Në çdo rast, ky kusht konsiderohet i përmbushur në rast se mungesa e qiradhënies së këtyre ambienteve që zënë një pjesë të vogël të ndërtesës justifikohet nga rrethanat ekonomike të pavarura nga vullneti i qiradhënësit, si p.sh.: fillimi i veprimtarisë së qiramarrësit, konjuktura të tregut imobiliar, fatkeqësi etj., të kësaj natyre.

5. Nuk kërkohet të bëhet rregullim i TVSH-së së zbritshme në situatat kur gjatë kohëzgjatjes së zgjedhjes konstatohet një mosdhënie me qira e përkohshme e ndërtesës, e justifikuar saktësisht nga rrethana ekonomike që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e qiradhënësit. I tillë është rasti kur, për arsye të ndryshimit të qiramarrësit, gjatë periudhës në të cilën qiradhënësi kryen përpjekjet e nevojshme për gjetjen e një qiramarrësi të ri.

6. Nëse qiradhënësi ndodhet në një situatë ku ambientet mbeten të lira për një kohë të gjatë, më shumë se një vit, pra e drejta e zgjedhjes pavarësisht dëshirës së personit të tatueshëm nuk mund të ushtrohet ose nëse veprimtaria e qiradhënies së ndërtesës së personit të tatueshëm ndërpritet, ose si pasojë e refuzimit të rinovimit të kontratës, ose për shkak të pushimit të efekteve të zgjedhjes, ose heqjes dorë prej saj, atëherë personi i tatueshëm duhet të procedojë me rregullimin e TVSH-së së zbritur më parë, nëse ndërprerja e transaksioneve të tatueshme ndodh para fillimit të vitit të nëntë pas vitit kur fillon e drejta e zbritjes. Rregullimi i TVSH-së përkon me shumën e TVSH-së të zbritur më parë, e cila zvogëlohet me një të dhjetën për çdo vit, pas datës në të cilën ka përfunduar ndërtesa.

7. Në rastin kur zgjedhja përfundon ose periudha për të cilën ushtrohet zgjedhja është më e shkurtër se afati për të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes së TVSH-së për pasurinë e paluajtshme, përfundimi i zgjedhjes sjell për pasojë detyrimin për rregullimin e TVSH-së së zbritur fillimisht nga personi i tatueshëm, nëse është rasti.

Neni 7/1

E drejta e zbritjes kur ushtrohet zgjedhja për furnizimin e ndërtesave

1. E drejta e zbritjes ushtrohet në përputhje me dispozitat dhe përcaktimet në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.
2. Në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për çdo ndërtesë ose grup ndërtesash që janë përfshirë për t’u trajtuar si të tatueshme ose për çdo ndërtesë ose grup - ndërtesash të cilat i furnizon si të përjashtuara nga TVSH-ja, furnizuesi duhet të evidentojë veçmas zbritjet e TVSH-së për secilën nga ndërtesat ose grup - ndërtesat.
3. Gjithashtu, personi i tatueshëm i cili, përveç veprimtarisë së shitjes së ndërtesave ushtron edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet të evidentojë veçmas blerjet për secilën kategori të veprimtarisë.
4. Në rastin kur ndërtesa ose grupi i ndërtesave, për të cilën është kërkuar zgjedhja, përfshin ndërtesa (ambiente) për të cilat është ushtruar e drejta e zgjedhjes për t’i trajtuar të tatueshme me TVSH, si dhe ndërtesa (ambiente) për të cilat nuk ushtrohet ose nuk është e lejuar të ushtrohet e drejta e zgjedhjes si ambientet për banim ose ambiente për nevojat e veprimtarisë së blerësve të patatueshëm ose të përjashtuar nga TVSH-ja, të cilët në kontratën e qirasë nuk kanë formuluar shprehimisht të drejtën e zgjedhjes, TVSH-ja zbritet vetëm për tërësinë e ambienteve të përfshira realisht nga e drejta e zgjedhjes së TVSH-së.
5. Nëse furnizuesi i ndërtesës ndodhet në një situatë sipas së cilës e drejta e zgjedhjes, pavarësisht nga vullneti i tij, nuk mund të ushtrohet, ose nëse veprimtaria e tij ndërpritet, ose për shkak të pushimit të efekteve të zgjedhjes ose heqjes dorë prej saj, apo çdo arsye tjetër, atëherë personi i tatueshëm duhet të procedojë me rregullimin e TVSH-së së zbritur më parë, nëse ndërprerja e transaksioneve të tatueshme ndodh para fillimit të vitit të nëntë pas vitit kur fillon e drejta e zbritjes. Rregullimi i TVSH-së përkon me shumën e TVSHsë të zbritur më parë, e cila zvogëlohet me një të dhjetën për çdo vit, pas datës në të cilën ka përfunduar ndërtesa.
6. Në rastin kur zgjedhja përfundon ose periudha për të cilën ushtrohet zgjedhja është më e shkurtër se afati për të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes së TVSH-së për pasurinë e paluajtshme, përfundimi i zgjedhjes sjell për pasojë detyrimin për rregullimin e TVSH-së së zbritur fillimisht nga personi i tatueshëm.

(Ndryshuar me VKM nr. 8, dt. 11.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 16 janar 2017).

Neni 8

Përcaktimi i listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe procedurat e përjashtimeve e të kriterëve përkatëse

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, makineritë dhe pajisjet që janë direkt të lidhura me investimin të kryera prej personave të tatueshëm të cilët:

a) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv pavarësisht nga vlera e investimit;

c) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;

ç) i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre;

~~d) në zbatim të pikës 41, të nenit 56 të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja importimi i makinerive bujqësore. (Shfuqizuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)~~

2. Importimi i makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importuesi është vetë personi i tatueshëm që realizon investimin ose përdor makinerinë ose pajisjen. Personat e tatueshëm, që importojnë makineri dhe pajisje për shitje, nuk janë subjekte përfituese të përjashtimit nga TVSH-ja, ~~me përjashtim të tatimpaguesve që importojnë makineri bujqësore sipas sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij neni.~~

(Shfuqizuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)

(Ndryshuar me VKM nr. 8, dt. 11.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 16 janar 2017).

3. Lista e makinerive dhe pajisjeve, që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin, është e përcaktuar në anekset 1 e 2, ndërsa lista e makinave bujqësore, sipas shkronjës “n”, të nenit 51, të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është përcaktuar në aneksin 1/A, që i bashkëlidhet këtij vendimi. **Lista e kodeve të aneksit 2 aplikohet për importet e subjekteve me aktivitet peshkimi, përfituese të përjashtimit nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza për gazoilin, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.18, datë 15.6.2015, “Për procedurat dhe kriteret e furnizimit të anijeve të peshkimit me karburant (gazoil), me përjashtim nga taksa e qarkullimit, taksa e karbonit dhe akciza.**

Lista e makinerive dhe e pajisjeve, që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin, në funksion të realizimit të kontratave të investimit, me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë lekë, për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar prodhimi mbi 0.5 mw, është sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Autoriteti doganor bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë për të evidentuar subjektet e autorizuar/licencuara për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar prodhimi mbi 0.5 mw, për të cilat aplikohet lista e makinerive dhe e pajisjeve sipas aneksit 3.

(Ndryshuar me VKM nr. 652, datë 10.11.2017, botuar në FLZ nr. 200 datë 20.11.2017).

(Ndryshuar me VKM nr.212, datë 20.04.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 27.04.2018)

(Ndryshuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)

(Ndryshuar me VKM nr.145, datë 20.03.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.36, datë 25.03.2019)

4. Personat e tatueshëm të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të cilët importojnë makineri dhe pajisje për të përfituar përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar, duhet të pajisen me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja nga autoriteti doganor. Për marrjen e këtij autorizimi, subjektet duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dokumentet, si më poshtë vijon:

4.1 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- b) kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit e barabartë ose mbi 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);
- c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është e barabartë ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;
- ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe periudhën e instalimit;
- dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.2 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- (Shkronja “b”, e pikës 4.2, shfuqizohet me VKM nr. 652, datë 10.11.2017. FLZ nr. 200 datë 20.11.2017)

Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e përpunimit aktiv. Gjithashtu, verifikimi nëse ka ose jo autorizimin e lëshuar nga autoriteti doganor si tatimpagues në regjimin e përpunimit aktiv kryhet brenda strukturave doganore.

(Ndryshuar me VKM nr. 652, datë 10.11.2017, botuar në FLZ nr.200 datë 20.11.2017).

- c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për të gjithë kohëzgjatjen e investimit;
- ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;
- dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.3 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

- a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- (Shkronja “b”, e pikës 4.3, shfuqizohet me VKM nr. 652, date 10.11.2017. FLZ nr.200 date 20.11.2017)

Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me kopje të ekstraktit të QKB-së, ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e agrobiznesit.

(Ndryshuar me VKM nr. 652, date 10.11.2017, botuar ne FLZ nr. 200 datë 20.11.2017)

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin dhe kohëzgjatjen e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj;

ë) Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.

(Ndryshuar me VKM nr. 841, dt. 14.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 14.10.2015.)

4.4 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

(Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 4.4, shfuqizohen me VKM nr. 652, date 10.11.2017. FLZ nr. 200 date 20.11.2017).

Autoriteti doganor e plotëson dokumentacionin e mësipërm me vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm, që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogël dhe ushtron aktivitet prodhues, si dhe me kopje të ekstraktit të QKB-së.

(Ndryshuar me VKM nr. 652, datë 10.11.2017, botuar në FLZ nr. 200 datë 20.11.2017)

ç) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese që do të importohen dhe për periudhën e instalimit.

d) Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.

(Ndryshuar me VKM nr. 841, dt. 14.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 14.10.2015.)

4.5 (Shfuqizuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)

4.6 Importimet e makinerive e të pajisjeve të kryera në përputhje me pikat 38 dhe 41, të nenit 56, të ligjit, subjekt i këtij vendimi, të bëra me ndërmjetësimin e kompanive *leasing* janë subjekt i përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Subjektet përfituese duhet të paraqesin në doganë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Respektivisht sipas kategorisë, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në pikat 4.1; 4.2; 4.3, 4.4 e 4.5 të këtij neni.

b) Kopje të kontratës me kompaninë *leasing*

5. Me plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, autoriteti doganor e pajis personin e tatueshëm me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, në të cilin përcaktohet edhe dega doganore mbikëqyrëse. Nëse administrata doganore nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, autorizimi konsiderohet i dhënë. Një kopje e autorizimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPD-ja hap një regjistër të veçantë për importet që kryhen nga tatimpaguesit importues.

Për çdo import të makinerive e të pajisjeve, personat e tatueshëm duhet të paraqesin kërkesat e parashtruara në këtë vendim për t'u pajisur me autorizim përjashtimi.

(Ndryshuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)

Neni 8/1

Përcaktimi i listës së kategorive të *input*-eve bujqësore dhe i listës së lëndëve të para për prodhimin e barnave

1. Në zbatim të shkronjës “nj”, të nenit 51, të ligjit, furnizimi i *input*-eve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të NKM-së, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Lista e kategorive të *input*-eve bujqësore është e përcaktuar në aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në zbatim të pikës 42, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import lëndët e para, që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të importuara nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat.

Lista e lëndëve të para, që përdoren për prodhimin e barnave, është e përcaktuar në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

(Ndryshuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019)

Neni 9

Përcaktimi i kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv janë personat e tatueshëm që kryejnë aktivitet të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në fushën e përpunimit aktiv, sipas përcaktimeve në “Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”. Nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

2. Për zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja në import sipas këtij neni, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e agrobiznesit janë subjektet fizike ose juridike, që merren me prodhimin ose përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, të akuakulturës, peshkimit dhe pyjeve, si dhe prodhimin e përpunimin e imputeve bujqësore, si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide dhe medikamente veterinarë:

2.1 Kategoritë kryesore të agrobiznesit janë:

a) kultivimi dhe prodhimi i produkteve bujqësore bazë, të tilla si të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale që vijnë direkt nga fusha apo stalla dhe që janë të papërpunuara, si p.sh.: frutat, perimet, patatet, drithërat, ullinjtë, mishi, peshku, qumështi, vezët, mjalti;

b) përpunimi i të gjitha produkteve bujqësore, të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 2.1, të këtij vendimi, të tilla si: lëngjet, kompostot, mielli, buka, vaji i ullirit, sallamrat, proshutat, peshku i përpunuar, të gjitha nënproduktet e qumështit etj.;

c) kultivimi, prodhimi apo përpunimi i produkteve pyjore, të tilla si: bimët dekorative, bimët aromatike-mjekësore, kërpudhat etj.;

ç) prodhimi dhe përpunimi i imputeve bujqësore, të tilla si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide;

d) mbarështimi i gjësë së gjallë, si: gjedhë, të imta, njëthundrakë, derra, shpendë, lepuj, bletë, kërmij, peshq, midhje.

Neni 10

Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së

1. Për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, kategoritë e eksportuesve në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;

b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;

c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;

ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2. Personat e tatueshëm, që plotësojnë kriteret sipas pikës 1, të këtij neni, rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, si persona me risk zero.

3. Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut.

Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t'i nënshtrohet procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në të kundërt, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.

4. Të gjithë personat e tjerë të tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.

(Ndryshuar me VKM nr. 460, dt. 22.06.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 120, datë 28 qershor 2016).

Neni 10/1

Afati i paraqitjes së deklaratës dhe regjistrave përmbledhës për kategorinë e personave të tatueshëm me qarkullim vjetor dy deri në pesë milionë lekë

Në zbatim të nenit 107, të ligjit, personat e tatueshëm, që realizojnë një qarkullim vjetor mbi kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të përcaktuar në pikën 1, të nenit 11, të këtij vendimi, por jo më shumë se 5 milionë lekë, dorëzojnë deklaratën e TVSH-së mbi baza mujore, brenda datës 14 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 109 të ligjit, kjo kategori personash të tatueshëm e shoqëron deklaratën e TVSH-së me regjistrat përmbledhës, përkatësisht librin e blerjes dhe librin e shitjes, mbi baza mujore, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik.

Parashikimet e mësipërme nuk zbatohen për personat e tatueshëm, për të cilët kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është zero, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i tyre.

(Shfuqizohet me efekt nga 1 Janari 2021 me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020.)

Neni 11

Përcaktimi i kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)

1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh në një vit kalendarik. Personi i tatueshëm ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së, në përputhje me përcaktimet e nenit 120, të ligjit, nëse qarkullimi vjetor është më i madh se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

(Ndryshuar me efekt nga 1 Janari 2021 me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020.)

2. Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në për personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i tyre, është zero. Të gjithë këta janë persona të tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit.

(Shfuqizohet me efekt nga 1 Janari 2021 me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020.)

3. Për prodhuesit bujqësorë, për të cilët zbatohet regjimi i veçantë i skemës së kompensimit dhe që e zhvillojnë veprimtarinë ekonomike si fermerë individualë, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh në një vit kalendarik.

Prodhuesit bujqësorë, për të cilët zbatohet regjimi i veçantë i skemës së kompensimit të fermerëve, por që e zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore të organizuar si shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (SHBB), janë të përjashtuar nga aplikimi i kufirit si më sipër, për regjimin e veçantë të skemës së kompensimit, me kushtin që kjo SHBB të kryejë vetëm veprimtari të shitjes së produkteve bujqësore të anëtarëve të saj të tatimpagues që nuk janë pjesë e skemës së kompensimit. Në këtë rast, blerësi, person i tatueshëm, lëshon faturë tatimore vetëm për shitësin, shoqëri e bashkëpunimit bujqësor, ndërsa kjo e fundit nuk lëshon faturë tatimore, sipas parimeve të kësaj skeme për fermerët anëtarë të SHBB-së. Nëse shoqëria e bashkëpunimit bujqësor, krahas shitjeve në kuadrin e regjimit të veçantë të skemës së

kompensimit të fermerëve, kryen edhe veprimtari të tjera, regjistrohet në skemën normale të aplikimit të TVSH-së.

(Shfuqizuar me efekt nga 1 Janari 2021 me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020.)

Neni 11/1

Kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkallës së reduktuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 49, të ligjit, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese, sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin e fushës së turizmit, është 6 për qind.

Për qëllime të zbatimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së, me termin “furnizim i shërbimit të akomodimit” nënkuptohet furnizimi i shërbimit të fjetjes në strukturat akomoduese, sipas legjislacionit për turizmin, pa përfshirë furnizimin e ushqimit apo çdo furnizim tjetër, të ofruar nga këto struktura. Përfshirë, “furnizimi i shërbimit të akomodimit” nënkupton, përveç shërbimit të fjetjes, edhe furnizimin e ushqimit (mëngjesit), në rastet kur struktura akomoduese e ofron mëngjesin brenda çmimit të furnizimit të shërbimit të fjetjes.

Personi i tatueshëm, i cili ushtron veprimtari në fushën e akomodimit në strukturat akomoduese, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës për turizmin, evidenton veçmas në faturë furnizimin e shërbimit të akomodimit, për të cilin aplikon shkallën e reduktuar të TVSH-së, në masën 6 për qind. Për çdo furnizim tjetër të tatueshëm, të ofruar në strukturat akomoduese, personi i tatueshëm aplikon shkallën standarde të TVSH-së, 20 për qind, sipas përcaktimeve në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.

Personat e tatueshëm, që aplikojnë shkallën e reduktuar të TVSH-së sipas këtij neni, janë personat që ushtrojnë vetëm veprimtari ekonomike në fushën e strukturave akomoduese, sipas legjislacionit të fushës për turizmin. Nëse personi i tatueshëm ushtron edhe veprimtari të tjera, përveç asaj në fushën e strukturave akomoduese, atëherë duhet të jetë i regjistruar si person i tatueshëm më vete, për qëllime të veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese.

Aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së nuk kufizon të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Zbritja e TVSH-së lind dhe ushtrohet në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, me qëllim aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, personat e tatueshëm, të cilët, përveç veprimtarisë në fushën e strukturave akomoduese, kryejnë edhe veprimtari të tjera, regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit si persona të tatueshëm më vete, duke riorganizuar ose jo veprimtarinë e tyre ekonomike, siç përcaktohet në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

(Ndryshuar me VKM nr. 652, datë 10.11.2017, botuar në FLZ nr. 200 datë 20.11.2017).

Neni 12

Organet zbatuese

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Neni 13

Shfuqizime

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit”, nr. 202, datë 9.4.2014, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve për eksportuesit për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”; nr. 180, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, të ndryshuar”; nr. 178, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e procedurave, kriterëve, llojit dhe sasisë së përjashtimeve nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në import dhe brenda vendit, për produktet hekur dhe çimento për ndërtimin e hidrocentraleve”; nr. 1058, datë 21.10.2009, “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)”, i ndryshuar; nr. 1679, datë 24.12.2008, “Për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik”, dhe nr. 559, datë 16.8.2006, “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH, sh.a.”, i ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”, me përjashtim të pikës 1, të nenit 2, të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi në datën 1 prill 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet në datën 1.1.2021.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 200, datë 31 dhjetor 2014.

Ndryshuar me VKM nr. 13, dt. 14.01.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 23 janar 2015.

Ndryshuar me VKM nr. 841, dt. 14.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 14.10.2015.

Ndryshuar me VKM nr. 176, dt. 09.03.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 39, datë 15mars 2016.

Ndryshuar me VKM nr. 460, dt. 22.06.2016. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 120, datë 28 qershor 2016.

Tabelat plotësuese që i bashkëlidhen vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 200, datë 31.12.2014.

Aneksi bashkëlidhur vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, emërtohet “aneksi 1” dhe në fund të tij shtohen kodet, sipas aneksit I/I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Me VKM 176 datë 09.03.2016 shtohen kodet 7305 11 00 dhe 7307 9391 si dhe hiqet kodi 8414

Ndryshuar me VKM nr. 8, dt. 11.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 16 janar 2017.

Ndryshuar me VKM nr. 84, dt. 08.02.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 15.02.2017

Ndryshuar me VKM nr. 652, datë 10.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare. Nr. 200 datë 20.11.2017.

Ndryshuar me VKM nr.212, datë 20.04.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 27.04.2018

Ndryshuar me VKM nr.12, datë 09.01.2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.1, datë 11.01.2019

Ndryshuar me VKM Nr.145 datë 20.03.2019. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 36 datë 25.03.2019

Ndryshuar me VKM Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07.2020

Kodet NK	Pershkrimi
3917 32 00	Tuba të papërforcuara apo të pakombinuara ndryshe me materiale të tjera pa përshtatje
3917 23 90	Të tjera.
3917 33 00	Të tjera jo të përforcuara apo të kombinuara ndryshe me materiale të tjera me pajisje shtesë.
7304 29 90	Të një diametri më tepër se 406,4 mm.
7304 39 98	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej gize apo çelik jo të lidhur diametër të jashtëm më tepër se 406,4 mm.
7304 41 00	Tuba prej çeliku të pandryshkshëm të tërhequr në të ftohtë apo të petëzuar në të ftohtë.
7304 49 99	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej çeliku të pandryshkshëm të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm.
7304 59 99	Tuba të një seksioni kryq rrethor, prej çeliqueve të tjerë të lidhur të një diametri të jashtëm më tepër se 406,4 mm.
7305 31 00	Të salduar për së gjati.
7307 29 10	Përshtatje e tubave të filetuara.
7308 20 00	Kullat dhe shtylla për grilla.
7311 00 99	1000 litra apo më shumë.
8412 21 20	Sistem hidraulik (motor) me veprim linear.
8412 21 80	Motore hidraulike ndryshe nga turbo-reaktivët.
8413 50 80	Pompa volumetrike jo me piston

8413 60 31	Pompa volumetrike rrotulluese me fuqi hidraulike me lëng
8414 59 20	Ventilator aksial.
8414 59 40	Ventilator centrifugale.
8428	Makineri të tjera ngritëse, bartjeje apo shkarkimi (psh, ashensorët, eskaloret, konvejerët, teleferikët):
8428 20	Elevatorët dhe kovejerët pneumatikë
8428 10	Ashensorët e minierave
8431 31 00	Pjesët e ashensoreve të minierave apo eskalatorëve.
8431 43 00	Pjesët për makineritë shpuese apo zhytëse të nënkreut 8430 41 apo 8430 49.
8431 49 20	Pjesë të makinerive të kreut 8426, 8429 apo 8430, prej gize e derdhur apo çeliku te derdhur.
8437 90 00	Pjesët.
8467 11	Tipi me rrotullim (përfshi rrotullim- goditje të kombinuar):
8467 22 10	Sharra elektrike me zinxhirë.
8467 22 30	Sharrë disk.
8474	Makineri për zgjedhjen shoshimin veçimin larje therimin bluarjen, përzierje oksideve, gurëve, xeheroreve ose substancave të tjera minerale në formë të ngurtë (përfshi në formë pudre ose paste); makineri për aglomerimin, dhënien forme ose kallëp i lëndëve djegese të ngurta minerale, pastave qeramike, çimentove të pakalitura, materialeve plastifikuese apo produkteve të tjera minerale në formë pluhuri apo paste; makinat për modulet e formimit të fonderisë apo të rerave.

8503 00 99	Pjesët e përshtatshme për t'u përdorur vetëm ose kryesisht me makinat e kreut 8501 ose 8502, të ndryshme nga prej gize të derdhur apo çeliku të derdhur.
8504 40 55	Karikues akumulatorësh
8504 40 82	Rektifikuesit
8504 40 88	Që kanë një kapacitet të mbajtjes së energjisë më tepër se 7,5 kVA.
8451 29 00	Makinë tharëse me kapacitet më shumë se 10 kg.
8451 30 00	Makina dhe presa hekurosje (përfshirë preset me djegie).
8451 40 00	Makineri për larje zbardhim ngjyrosje.
8479 30 90	Makineri për prerjen e drurit dhe të tapës.
8535 40 00	Rrufepritësit, kufizuesat e tensionit dhe zbutësit e mbitensionit.
8537 20 91	Bordet, panelet, konsolat, tavolinat, kabinetet dhe baza të tjera të paisura me dy ose më shumë aparate të kreut 8535 ose 8536 për kontroll elektrik ose shpërndarje e elektricitetit, përfshi ato bashkëngjitur instrumentave dhe aparateve të Kapitullit 90 dhe aparatet e kontrollit numerik ndryshe nga aparaturat e hapjes apo mbylljes të kreut 8517, për një voltazh më tepër se 1000 V por jo më tepër se 72.5 KV.
8544 60 90	Përcjellësat e tjerë elektrike për një tension që e kalon 1000 V me përcjellës të tjerë të ndryshëm nga bakri.
8601 10 00	Të fuqizuara nga një burim elektrik i jashtëm.
8601 20 00	Të fuqizuara nga Akumulatorët elektrike
8602 10 00	Lokomotive diesel—elektrik.

8602 90 00	Të tjera.
8603 10 00	Të fuqizuara nga një burim elektrik i jashtëm.
8604 00 00	Mjetet levizëse të mirembajtjes ose shërbimit të hekurudhave ose tramvajeve, nëse janë apo jo vetëlevizëse (psh, punishtet, vincat, gatitesit e zhavorit, linjëzuesit e shinave , vagonet e testimit dhe mjetet levizëse për inspektimin e rrugës hekurudhore).
8605 00 00	Vagonet e pasagjereve të hekurudhes dhe tramvajave, jo vetëlevizës; vagonet e bagazhit, vagonet e postës dhe vagonet për qëllime të tjera speciale të hekurudhes ose tramvajt, jo vetëlevizës.
8606 10 00	Vagonë çisterne dhe të ngjashëm.
8606 30 00	Vagone dhe vagoneta.
8606 91 10	Të projektuara posaçërisht për transportin e materialeve shumë radioaktive (Euratom).
8606 91 80	Të tjera.
8606 92 00	Të hapur, me faqet anësore të palëvizshme të një lartësie që e kalon 60 cm (vagone dhe vagoneta).
8606 99 00	Të tjera (vagonë dhe vagoneta).
8607 11 00	Vagonetat dhe bissel - vagonetat drejtuese.
8607 12 00	Vagonetat dhe bissel - vagonetat e tjera.
8607 19 10	Boshtet, nëse janë ose jo të montuar, rrotat dhe pjesët e tyre.
8607 19 90	Pjesët e vagonetave, bissel- vagonetave dhe të ngjashmet.
8607 21 10	Frenat me ajër dhe pjesët e tyre me derdhje gize apo me derdhje çeliku.

8607 21 90	Të tjera.
8414 40 10	Që japin një rrjedhje për minutë jo më tepër se 2 cm ³
8414 40 90	Që japin një rrjedhje për minutë më tepër se 2 cm ³
8420 10 10	Të një lloji të përdorur në industrinë tekstile
8443 19 20	Për printimin e materialeve tekstile
8444 00 10	Makinat për stampim në të nxehtë
8444 00 90	Të tjera
8451 50 00	Makinat për rulimin, çrulimin, palosjen, prerjen apo zigzimin e pëlhurave tekstile
8451 80 30	Makinat për proceset përfundimtare apo përfundimin
8451 80 80	Të tjera
8452 21 00	Njësitet automatike
84 52 29 00	Të tjera
84 52 90 00	Mobilje, baza dhe mbulesa për makinat qepëse dhe pjesët e tyre; pjesët e tjera të makinave qepëse
8451 10 00	Makina pastrimi në të thatë

8451 21 00	Secila të një kapaciteti të pëlhurës së thatë jo më tepër se 10 kg
8451 50 00	Makinat për rulimin, çrullimin, palosjen, prerjen apo zigzimin e pëlhurave tekstile
8451 80 30	Makinat për proceset perfundimtare apo përfundimin
8451 80 80	Të tjera
8451 90 00	Pjesët
8452 30 00	Gjilpërat e makinave qepëse
8453 10 00	Makineri për përgatitjen, regjlen apo punimin e lëkurëve të përpunuara apo të papërpunuara
8453 20 00	Makineri për bërjen apo riparimin e veshjeve të këmbëve
8453 80 00	Makineri të tjera
8453 90 00	Pjesët
8607 30 00	Lidhësit me grep dhe pajisje të tjera lidhjeje, amortizatorët, dhe pjesët e tyre.
8607 91 10	Kutitë e aksit dhe pjesët e tyre.
8607 91 90	Të tjera.
8607 99 10	Kutitë e aksit dhe pjesët e tyre.

8607 99 80	Të tjera.
8608 00 00	Armaturat dhe fiksuesit e shinave hekurudhore ose tramvajeve; sinjalizuesit mekanike (përfshi elektromekanike), pajisjet mbrojtëse ose kontrolli trafiku për hekurudhat, tramvajet, rrugët, rrugët ujore brenda vendit, pajisjet e parkimit, instalimet në port ose aeroporte.
8609 00 10	Konteniere me një mbulesë plumbi kundër rrezatimit, për transportin e materialeve radioaktive (euratom).
8609 00 90	Të tjera.
9028 10 00	Matësat e gazit
9032 90 00	Pjesët dhe plotësuesit për instrumenta dhe aparate të rregullimit ose aparate të rregullimit ose kontrollit automatik.

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, hiqen kodet e mëposhtme:

8421 23 00 - - Filtrat e vajit ose naftës për motorët me djegie të brendshme;

8421 29 00 - -Të tjera;

8421 31 00 - - Filtrat e marrjes së ajrit për motorët me djegie të brendshme;

8414 20 80 - - Pompa dore për mjete të llojit biçikleta, motoçikleta, tricikla;

8414 20 80 - - Të tjera;

8438 80 10 - - Për përgatitjen e çajit apo të kafesë.

Ndryshuar me VKM nr. 841, dt. 14.10.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 14.10.2015.

Lista e kodeve bashkëlidhur këtij vendimi, të botuara në Flz. Nr. 206, dt. 8 janar 2015, u hoqën me VKM nr. 84, dt. 08.02.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, datë 15 shkurt 2017.

Në tabelën e mësipërme të hiqen kodet:

84136031, 84145920, 84145940, 84379000, 84672210, 84672230, 85030099, 85372091, 85446090, 86011000, 86012000, 86029000, 86031000, 86040000, 86050000, 86061000, 86063000, 86069110, 86069180, 86069200, 86069900 86071100, 86071200, 86071910, 86071990, 86072110, 86072190, 84529000, 84519000, 84523000, 84539000, 86079190, 86079910,

Ndryshuar me VKM nr.145 datw 20.03.2019, botuar nw Fletoren Zyrtare nr.36 datw 25.03.2019.

Në tabelën e mësipërme hiqen nënndarjet me kodet tarifore të mëposhtme:

84244100; 84244910; 84248210; 84289071; 84322100; 84322930; 84321000; 84322910; 84322990; 84322950; 84323100; 84323911; 84323919; 84323990; 84368010; 84324100; 84324200; 84328000; 84335100; 84335200; 84334000; 84332010; 84332050; 84332090; 84331110; 84331159; 84331190; 84331959; 84331970; 84331990; 84333000; 84335310; 84335330; 84335911; 84335919; 84341000; 84335100; 84361000; 84371000; 87011000; 87019110; 87019210; 87019310; 87019410; 87019510; 84193100.

LIDHJA 1.

Kodet NK	Përshkrimi
8410 11 00	Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që nuk i kalon 1 000 kw;
8410 12 00	Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 1 000 kË, por nuk i kalon 10 000 kË
8410 13 00	Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 10 000 kË
8410 90 00	Pjesët, përfshirë rregullatorët
9022 19 00	Skanerët me rreze X (përveç atyre të përdorur në mjekësi, kirurgji, stomatologji dhe veterinar) veterinar)
9406 00 31	Serrat

ANEKSI 1.1.

Përfshirimi nga TVSH-ja në import për kodet e listuara në aneksin 1.1 jepet vetëm në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë, të kryera në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të këtij vendimi.”

85255000	--- Aparatet e transmetimit
85291069	--- Të tjera
85291039	--- Të tjera
85439000	--- Pjesët
85437090	--- Të tjera
85285920	--- Monokrom
85285931	--- Me ekran të lëngshëm kristal (Teknologjia LCD)
85258019	--- Të tjera
85258099	--- Të tjera

85299092	--- Për kamerat televizive të nënkreut 8525 80 11 dhe 8525 80 19 dhe aparaturat e kreut 8527 dhe 8528
90021100	--- Për kamera, projektorë, ose zmadhues apo zvogëlues fotografikë
90069100	--- Për kamerat
85181095	--- Të tjera
85183095	--- Të tjera
84714900	--- Të tjera, të paraqitura në formë të sistemeve
84715000	--- Njësitë e procesimit ndryshe nga ato të nënkrerëve 8471 41 apo 8471 49, nëse përmbajnë apo jo në të njëjtën karkasë një apo dy prej tipave të mëposhtme të njësive : njësitë e ruajtjes, njësitë e hyrjes, njësitë e daljes
85176200	--- Makinat për marrjen, shndërrimin dhe transmetimin ose përsëritjen e zërit, imazhit ose të dhënave të tjera, përfshi aparatet e komutacionit dhe routing
85312020	--- Që kanë të trupëzuar dioda drite emetuese (LED)
85312040	--- Që kanë të trupëzuar pajisje matrica aktive me kristal të lëngët (LCD)
94054010	--- Prozhektorët dhe ndriçuesit prozhektor
94054031	--- Të një lloji të përdorur me llambat inkandeshente
94054035	--- Të një lloji të përdorur me llambat fluoreshente në formë tubi
94054039	--- Të tjera
94054099	--- Të tjera
85423190	--- Të tjera
85238099	--- Të tjera
85044088	--- Që kanë një kapacitet të mbajtjes së energjisë më tepër se 7,5 kVA
84158300	--- E papërfshirë me një njësi ftohjeje
84159000	--- Pjesët
847989	--- Të tjera:
84144010	--- Që japin një rrjedhje për minute jo më tepër se 2 cm ³
84212100	--- Për filtrimin ose pastrimin e ujit
84158200	--- Të tjera, e përfshirë me një njësi ftohjeje
84158100	--- Të trupëzuar me një njësi ftohjeje dhe një valvol për alternimin e ciklit të ftohje/ngrohjes

ANEKSI 1/A

LISTA E MAKINAVE BUJQËSORE TË PËRJASHTUARA NGA TVSH-ja NË IMPORT DHE BRENDË VENDIT

1. Pompa spërkatëse (sprucuesit), tërheqëse ose të varura në traktor, të pajisura me motor elektrik, me djegie të brendshme ose që marrin fuqinë nga traktori ose vetëlëvizëse me motor individual (kodet sipas NKM-së 84244100, 84244910).
2. Pompa ujitëse tërheqëse ose të varura në traktor, të pajisura me motor elektrik, me djegie të brendshme ose që marrin fuqinë nga traktori, dhe impiantet vaditëse për fusha të hapura, sera ose pemëtore (kodet sipas NKM-së 84248210).

3. Pirunë ngritës për përdorim në bujqësi (kodet sipas NKM-së 84271010).
4. Ngarkuesit dhe shtytësit që montohen në traktorë (kodet sipas NKM-së 84289071).
5. Lesat me dhe pa disk (kodet sipas NKM-së 84322100, 84322930).
6. Plugjet (kodet sipas NKM-së 84321000);
7. Kultivatorët (kodet sipas NKM-së 84322910).
8. Shkriftuesit (kodet sipas NKM-së 84322910).
9. Rulat për lëndina (kodet sipas NKM-së 8432 29 90).
10. Rotovatorë (freza, grirëse degësh dhe bari) (kodet sipas NKM-së 84322950).
11. Farëmbjellës, bimëmbjellës, zhardhokmbjellës, transplantues bujqësore me dhe pa frezim, me dhe pa precision (kodet sipas NKM-së 84323100, 84323911, 84323919, 84323990).
12. Makinat e mbjelljes dhe shkuljes së fidanëve dhe pemëve (kodet sipas NKM-së 84368010).
13. Shpërndarësit e plehrave kimike (kodet sipas NKM-së 84324100, 84324200).
14. Makina përpunuese të plehut organik, pastruese, përzierëse, transportuese dhe shpërndarëse; kodet sipas NKM-së 8432 80 00).
15. Makina korrje apo shirje (kodet sipas NKM-së 84335100, 84335200).
16. Presat për ambalazhimin e dengjeve të kashtës apo tagjisë (kodet sipas NKM-së 84334000).
17. Makinat korrëse të barit të njomë apo të thatë, që tërhiqen ose marrin fuqinë nga traktori ose të vetëdrejtuar, me ose pa motor (kodet sipas NK-së 84332010 84332050, 84332090).
18. Kositëse për lëndinat me ose pa motor, elektrike apo me djegie të brendshme, të vetëdrejtuar ose të tërhequra nga traktori (kodet sipas NKM-së 84331110, 84331159, 84331190, 84331959, 84331970, 84331990).
19. Krasitëse që montohen në traktor ose tërhiqen nga traktori, me bateri ose ajër, me dhe pa depozita ajri, vjelësit e specializuar dhe transportuesit e specializuar (të vëna në lëvizje nga traktori ose me motor individual); Kodi sipas NKM-së 84368010; 84388099).
20. Lidhëse dhe ambalazhim të barit të thatë ose të njomë (kodet sipas NKM-së 84333000).
21. Shkulëse të rrënjëve ose zhardhokëve, panxharit etj., me motor dhe pa motor të tërhequra nga traktori ose jo (kodet sipas NKM-së 84335310, 84335330).
22. Korrësit e foragjereve dhe silazhuesit me motor dhe pa motor, të vetëdrejtuar ose të tërhequra nga traktori (kodet sipas NKM-së 84335911, 84335919).
23. Mjelësit e qumështit, sistemet e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit të bagëtive dhe shpendëve (kodet sipas NKM-së 84341000).

24. Makinë korrje shirje e kombinuar; makineri për përgatitjen e ushqimeve të kafshëve (kodet sipas NKM-së 84335100; 84361000).

25. Makinat për seleksionimin dhe klasifikimin e farave, drithërave apo fruta–zarzavateve (kodet sipas NKM-së 84371000).

26. Motokultivatorët e ndryshëm me një aks (kodet sipas NKM-së 87011000).

27. Traktorë bujqësorë me goma dhe me zinxhirë (kodet sipas NKM-së 87019110, 87019210, 87019310, 87019410, 87019510, 87013000).

28. Tharësit për produktet bujqësore (kodet sipas NKM-së 8419 31 00).

(Aneksi 1/A u shtua me VKM nr.145 datë 20.03.2019 ,botuar në Fletoren Zyrtare nr.36 datë 25.03.2019)

ANEKSI 2

Kodi tarifar	Përshkrimi
54011018	----- Të tjera
54081000	– Pëlhura të endura fituar nga fije të viskozitetit të lartë, prej rajon
54082100	– – Të zbardhura apo të pazbardhura
540822	– – Të ngjyrosura
54082300	Prej fijeve të ngjyrave të ndryshme
54082400	– – Të stampuara
54083100	– – Të pazbardhura apo të zbardhura
54083200	– – Të ngjyrosura
54083300	– – Prej fijeve të ngjyrave të ndryshme
54083400	– – Të stampuara
56075019	----- Të tjera
56075090	– – Prej fibrave të tjera sintetike
560811	– – Rrjeta të ndërtuara për peshkim
73121020	– – Prej çeliku të pandryshkshëm
73129000	– Të tjera
73160000	Spiranca për anije dhe spiranca për barka dhe pjesët e tyre, prej gize
840721	– Motorët e jashtëm
840729	– – Të tjera
840810	Motorët e shtytjes përpara të marinës
84131900	– – Të tjera
84136061	----- Me fuqi hidraulike me lëng
841810	– Ftohës-ngrirësat e kombinuar, të përshtatur me dyer të jashtme të

841830	– Ngrirës të tipit pingul (me hapje nga lart), që nuk e kalojnë një
841840	– Ngrirës të tipit dollap (me hapje ballore), që nuk e kalojnë një
841850	– Të tjera mobilieri (kabinete, dollapë, banakë, numëruar me afishim dhe të ngjashme) për ruajtjen dhe shfaqjen, ftohës të trupëzuar apo dhe të ngjashëm) për ruajtjen dhe shfaqjen, ftohës të trupëzuar apo
841861	– – Pompat e nxehtësisë ndryshe nga makinat e ajrit të kondicionuar të
841869	– – Të tjera
84254200	– – Krikët dhe ngritësit e tjerë, hidraulike
84263000	– Vinçat me krah portal apo pedestal
84269900	– – Të tjera
84821090	– – Të tjera
84871010	– – Prej bronzi
84871090	– – Të tjera
85123090	– – Të tjera
85308000	– Pajisje të tjera
890200	Anijet e peshkimit; vaporet fabrike dhe anije të tjera për përpunimin
89069091	– – – Me peshë jo më shumë se 100 kg secila
89069099	– – – Të tjera
90141000	– Busullat për gjetjen e drejtimit
90142020	– – Sisteme navigimi inerciale
90142080	– – Të tjera
90148000	– Instrumente dhe pajisje të tjera
90151010	– – Elektronike
90151090	– – Të tjera
90153010	– – Elektronike
90153090	– – Të tjera
90173000	– Mikrometrat, kaliperat dhe veglat matëse
901780	Instrumente të tjera
90258080	– – – Të tjera
90262020	– – Elektronik
90262080	– – – Të tjera
9507	Kallamat e peshkimit, grepat dhe pajime të tjera të peshkimit; rrjetat e vendosjes së peshkut, rrjetat e fluturave dhe rrjetat e vendosjes së peshkut, rrjetat e fluturave dhe rrjetat e ngjashme; “zogjtë” për

ANEKSI 2, u shtua me VKM nr. 652, datë 10.11.2017, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 200, datë 20.11.2017.

ANEKSI 3

LISTA E MAKINERIVE DHE E PAJISJEVE QË JANË DREJTPËRDREJT TË LIDHURA ME INVESTIMIN, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË KONTRATAVE ME VLERË TË BARABARTË OSE MË TË MADHE SE 50 MILIONË LEKË, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME NGA DIELLI, ME FUQI TË INSTALUAR PRODHIMI MBI 0.5 mw

Nr. rendor	Kodi tarifar	Përshkrimi i mallrave NKM 2018
1	8504 21	Me kapacitet fuqie që nuk e kalon 650 kVA
2	8504 22	Më tepër se 650 kVA por jo më tepër se 1 600 kVA
3	8504 22	Më tepër se 1 600 kVA por jo më tepër se 10 000 kVA
4	8504 23	Me kapacitet fuqie që e kalon 10 000 kVA
5	8504 31	Për matien e tensionit
6	8504 31	Të tiera
7	8504 31	Të tiera
8	8504 32	Me kapacitet fuqie që e kalon 1 kVA por nuk e kalon 16
9	8504 33	Me kapacitet fuqie që e kalon 16 kVA por nuk e kalon 500
10	8504 34	Me kapacitet fuqie që e kalon 500 kVA
11	8504 40	Të një lloji të përdorur me aparatet e telekomunikimit, makinat e përpunimit automatik të të dhënave dhe njësitë e tyre
12	8504 40	Karikues akumulatorësh
13	8504 40	Rektifikuesit
14	8504 40	Oë kanë një kapacitet të mbaities së energjisë jo më tepër se
15	8504 40	Oë kanë një kapacitet të mbaities së energjisë më tepër se 7,5
16	8504 40	Të tiera
17	8504 50	Të një lloji të përdorur me aparatet e telekomunikimit dhe për sigurimin e energjisë për makinat e përpunimit automatik të të dhënave dhe njësitë e tyre
18	8504 50	Të tiera
19	8507 50	Nickel-metal hydride
20	8507 60	Lithium-ion
21	8507 80	Akumulatorë të tierë
22	8534 00	Me elemente të tiera pasive
23	8536 10	Për një rrymë jo më tepër se 10 A
24	8536 10	Për një rrymë më tepër se 10 A por jo më tepër 63
25	8536 10	Të një rryme që i kalon 63 A
26	8536 20	Për një rrymë jo më tepër se 63 A
27	8536 20	Për një rrymë më tepër se 63 A
28	8536 30	Për një rrymë jo më tepër se 16 A
29	8536 30	Për një rrymë më tepër se 16 A por jo më tepër 125 A
30	8536 30	Të një rryme që i kalon 125 A
31	8537 10	Panelet e kontrolluara numerikisht me makina të përpunimit automatik të të dhënave të ndërtuara në të
32	8537 10	Kontrolluesit e memories së programueshme
33	8537 10	- Pajisje për futjen e të dhënave të ndjeshme ndaj prekjes (të ashtuquajtura ekrane me prekje) pa mundësi të shfaqjes së pamjes, projektuar që të përfshihen në pajisjet me ekrane, të cilat funksionojnë me anë të zbulimit të pranisë dhe të vendndodhjes së një prekjeje në sipërfaqen e ekranit
34	8537 10	Të tiera
35	8537 20	Për një voltazh më tepër se 1 000 V por jo më tepër se 72,5
36	8537 20	Për një voltazh më tepër se 72,5 kV

37	8538 10 00	Bordet, panelet, konsolat, tavolinat, kabineteve dhe bazave të tjera për mallrat e kreut 8537, jo të pajisura me aparaturat
38	8538 90	Montimet elektronike
39	8538 90	Të tjera
40	8538 90	Montimet elektronike
41	8538 90	Të tjera

42	8541 10 00	Diodat, të ndryshme nga diodat e ndjeshme ndaj dritës ose emetuese të dritës (LED)
43	8541 30 00	Tiristorët, diaket dhe triaket, të ndryshëm nga pajisjet të ndjeshme ndaj dritës
44	8541 40 10	Diodat emetuese të dritës (LED), përfshirë dhe diodat lazer
45	8541 40 90	Të tjera
46	8541 50 00	Pajisje të tjera givsmëpërcuese
47	8541 60 00	Kristalet piezoelektrike të montuara
